URDHËR
Nr. 106, datë 10.8.2021

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje dhe në zbatim të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; si dhe të VKM-së nr. 395, datë 13.5.2020, "Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, drejtorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, znj. Klodiana Guci.
2. Kompetencat e titullarit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin do të ushtrohen për periudhën nga data 12.8.2021 deri më datë 19.8.2021.
3. Nuk delegohen kompetenca të padelegueshme të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, znj. Klodiana Guci.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
I AGJENCISË SHTETËRORE
PËR SHPRONËSIMIN
Erlis Hereni